



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr.56, Datë 02.04.2024

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“HYDROBORSH” SH.P.K. PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR
TRANSFERIMIN (NËPËRMJET HIPOTEKIMIT) TË ASETEVE TË PALUAJTSHME
TË SAJ**

Në mbështetje të neneve 16, 20, gërma “a”, dhe 44 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; neneve 2, gërma “a”, 3, 4, gërmat “a” dhe “b”, 5, gërma “j”, 6, 7 dhe 8 të Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.07.2016; nenit 19, pika 1, gërma “a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; pikës 1.3 dhe pikës 1.6 të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 02.04.2024, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 770/1 prot., datë 29.03.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “HYDROBORSH” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve të paluajtshme të saj”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “HYDROBORSH” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet “Fterra” (1.08.MW) dhe “Fterra 2” (2 MW) me vendimin e bordit të ERE-s nr. 67, datë 06.06.2012.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 770 prot., datë 12.03.2024, shoqëria ka paraqitur aplikimin për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve të paluajtshme të saj, për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredihënëse, “BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE” sh.a.
- Nga shqyrtimi i aplikimit dhe në mbështetje të përcaktimeve të nenit 7 të Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.07.2016, rezulton se shoqëria “HYDROBORSH” sh.p.k., ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në nenin 7, pikat 1, gërmat “a”, “b”, “e”, “f” dhe “g”; 3, 4 dhe 6.

Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se nevojitet të plotësohet dokumentacioni në vijim:

Neni 7, Pika 1

- **gërma “c”**: Shoqëria duhet të depozitojë gjendjen e saj financiare aktuale dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve.
- **gërma “d”**: Shoqëria duhet të depozitojë një përshkrim të kandidatit të propozuar për transferimin e aseteve.
- **gërma “h”**: Shoqëria duhet të depozitojë listën e aseteve, ku të përcaktohet vlera e secilit aset dhe vlera totale e aseteve që kërkon të transferojë (hipotekojë) në favor të bankës.
- **gërma “i”**: Shoqëria duhet të depozitojë deklaratën me shkrim të personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehë gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit.
- **gërma “j”**: Shoqëria duhet të informojë ERE-n nëse ka pasur transferimit të aseteve të kryera më herët.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “HYDROBORSH” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve të paluajtshme të saj për të garantuar shlyerjen e detyrimeve ndaj palës kredithënëse “BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE” sh.a.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë, palën huadhënëse si dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË

Erjola SADUSHI